



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 274/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.06.2021, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Rivlerësimin me pikë të ofertave të paraqitura nga operatori ekonomik “Instituti Dekliada - ALB” SHPK dhe BOE “Invictus” SHPK & “Angerba” SHPK & “Tower” SHPK, në procedurën e prokurimit “E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit”, me objekt “Hartimi i studim-projektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto - Romanos - Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit”, me nr. REF-94911-05-08-2021, me fond limit 87,006,741 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Gjeokonsut & Co” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Instituti Dekliada - ALB” SHPK
Adresa: Rr. “Milto Tutulani”, Shkalla 2, ap.6, Tiranë.

Operatori ekonomik “Gjeokonsult & Co” SHPK
Adresa: Rr. “Sami Frashëri”, P.45, Shk.01, kati I, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Durrës
Adresa: Sheshi “Liria”, Durrës.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, Ligji nr. 97/2020 „Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 42 e vijues”. Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë

12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorëve ekonomik ankimes, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave dhe të dokumentacionit të dërguar nga ankimesit dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik“, ankimesit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se këta të fundit kanë qenë pjesëmarrës në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Ankimesit kanë paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” dhe ligjin nr. 97/2020 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nenit 42 e vijues.

I.3. Ankimesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.05.2021 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit”, me objekt “Hartimi i studim-projektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto - Romanos - Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit”, me nr. REF-94911-05-08-2021, me fond limit 87,006,741 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 27.05.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 28.05.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë, mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. "A & E Engineering" SHPK	Kualifikuar;
2. "Gjeokonsult & Co" SHPK	Kualifikuar;
3. "GR Albania" SHPK	Kualifikuar;
4. "HE & SK 11" SHPK & "MCE" SHPK	Kualifikuar;
5. "Illyrian Consulting Engineers" SHPK	Kualifikuar;
6. "Instituti Dekliada - ALB" SHPK	Kualifikuar;
7. "Invictus" SHPK & "Angerba" SHPK & "Tower" SHPK	Kualifikuar;
8. "Grama" SHPK & "Studio Services K-SA" SHPK & "Zenit & Co" SHPK	Skualifikuar;
9. "C.E.C Group" SHPK & "MF Invest Group" SHPK	Skualifikuar;
10. "InfraKonsult" SHPK	Skualifikuar;

II.4. Në datën 03.06.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e dytë të procedurës së prokurimit.

II.5. Me anë të shkresës nr. 4929/5 prot., datë 07.06.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik ofertues mbi klasifikimin përfundimtar si më poshtë vijon:

1. "Gjeokonsult & Co" SHPK me ofertë 49,000,000 lekë, Skualifikuar.
2. "Illyrian Consulting Engineers" SHPK me ofertë 57,025,000 lekë, Skualifikuar.
3. "A & E Engineering" SHPK me ofertë 65,000,000.00 lekë, Skualifikuar.
4. "HE & SK 11" SHPK & "MCE" SHPK me ofertë 65,000,000 lekë, Skualifikuar.
5. "GR Albania" SHPK me ofertë 68,000,000 lekë, Skualifikuar.
6. "Instituti Dekliada - ALB" SHPK me ofertë 77,432,100 lekë, Kualifikuar, velrësuar 85 pikë.
7. "Invictus" SHPK & "Angerba" SHPK & "Tower" SHPK me ofertë 82,145,534.70 lekë, Kualifikuar, velrësuar 88.52 pikë.

II.6. Në datën 09.06.2021, operatori ekonomik ankimues "Instituti Dekliada - ALB" SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kërkuar rivlerësimin me pikë të ofertës së tij, si dhe ofertës të paraqitur nga BOE "Invictus" SHPK & "Angerba" SHPK & "Tower" SHPK duke argumentuar si më poshtë vijon:
 "[...]Pasi u njohem me vlerësimin e propozimeve teknike, ne mbështetje të nenit 63 pika 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, 'Per Prokurimin Publik' i ndryshuar, e kundërshtojme atë si më poshtë vijon:

KVO ka vlerësuar me 85 pikë gjithsej Institutin Dekliada-Alb për të cilën gjykojmë se është totalisht e padrejte. Për kohën e zbatimit të kontratës grafiku i zbatimit dhe cmimi me i ulet kemi marrë piket maksimale pasi kemi ofertuar cmimin me të ulet dhe kohën me të shkurter të zbatimit.

Per sa i perket vlerësimit të nenkriterit cilesia vlerësimi mbështetje ne :

(iii) Cilësia [0 – 30]

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të zbatimit dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Instituti Dekliada-Alb SHPK ka një përvojë 15 vjeçare në hartimin e projekteve të ndryshme si në sektorin privat ashtu edhe në atë shtetëror dhe dokumentacioni i paraqitur nga ana jonë për vërtetimin e punëve të ngjashme tregon eksperiencën jashtëzakonisht të madhe që ka në fushën e konsulencës të ngjashme ose ekzaktesisht të njejte me objektin e prokurimit. E gjithë eksperiencia e këtyre tre viteve të fundit është e pasqyruar në cv e shoqërisë të shoqëruara dhe me kontrata të

ndryshme te paraqitura gjate procedures se tenderimit. Shoqeria jone ka nje eksperiencë shumë të gjatë dhe të thelluar në fushën e hartimit të projekteve për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit dhe per sistemimin e rrjetit të ujerave të shiut. Vlerësimi me pike i juaji duhet te bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentet e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke mos dhënë vlerësime me ndryshime të dukshme e të thella, në kushtet kur, dukshëm, operatori ekonomik provon dhe vërteton se ka paraqitur një dokumentacion plotë e të mjaftueshëm për t'u vlerësuar me pikët maksimale.

Bazuar ne sa me siper metodologjia e paraqitur nga ana jonë si operator ekonomik ka të trajtuar në detaje realizimin e projektit duke iu referuar dhe termave të referencës (detyrës së projektimit) të vënë në dispozicion nga ana juaj. Prandaj kërkojmë që dhe vlerësimi për metodologjinë të rishikohet në tërësi nga komisioni. Ju bejme me dije se metodologjia e propozuar nga ana jone i është përmbajtuar plotësisht kërkesave dhe detyrave të paraqitura në DST, pasi ka trajtuar të gjitha çështjet duke dhënë propozimet përkatëse të detajuara.

Lidhur me argumentet sa më sipër duhet te rivleresohemi nga ana juaj per nenkriterin e propozimit teknik me piket maksimale

Po keshu lidhur me nenkriterin organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë duhet te vleresohemi me piket maksimale pasi shoqeria jone eshte e pajisur me shume certifikata te standardeve te cilesise duke tejkaluuar kerkesat e DST dhe duke treguar qartazi qe jemi mese te kualifikuar per kete procedure.

Në grafik janë ndarë edhe etapat lidhur me zbatimin e cdo raporti apo projekti. Po kështu janë ndarë fazat dhe etapat përkatëse duke paraqitur shtrirjen në kohë e secilit prej kërkesave të DST. Ndërthurja në mënyrë korrekte me metodologjinë e propozuar tregon që plani i punës i paraqitur është shumë konkret në funksion të realizimit të kërkesave të detyrës së projektimit.

Instituti Dekliada Alb ka përshkruar strukturën dhe përmbajtjen e stafit të propozuar, duke e shoqëruar me një listë të detajuar në të cilën jepet pozicioni në kompani. Po kështu është ofruar një staf mbështetës më inxhinierë të kualifikuar. Po te vleresohen dokumentacionet mund te gjykohet mjaft lehte se kapacitetet tona te stafit ne kuader te organzimit jane shume here me te medha, pasi ne organigramen e saj Instituti ka nje staf prej 46 personash. Struktura ose organigrama e propozuar paraqet qartë mënyrën e organizimit të stafit për realizimin me sukses të kontratës duke parashikuar të gjitha elementet e nevojshme si logjistikë dhe personel inxhinierik dhe ekonomiko-administrativ.

B.O.E INVICTUS+ANGEBRA+TOWER SHPK jane vleresuar me 88.52 pike.

Vlen te theksohet qe duke qene se jemi ne kushtet e nje Procedure te Pershpejtuar -Rindertimi Sherbime në këtë projekt kompleks dhe me shtrirje pothuajse në te gjithë qytetin e Durrësit, gjykojme se projekti që do të hartohet është shumë me i arrire në rastet kur grupi i projektimit ka bashkëpunuar më parë me njëri tjetrin. Kjo ofron edhe siguri më të madhe për përgjegjësinë që do të marrin konsulentët. **B.O.E INVICTUS+ANGEBRA+TOWER SHPK** nuk kane patur bashkepunime te meparshme per procedura prokurimi te ngjashme, rrjedhimisht do te perballemi me situata te paparashikuara te cilat do ti sillni kosto te panevojshme ne kohe, per komunitetin qe perfiton nga zbatimi i ketij projekti.

Në rekomandimet e dhëna në Vendimet e KPP, gjykon se "... procesi i pikëzimit në procedurat e studimin projektimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues. " "...vlerësimi është i matshëm në kushte kur niveli i pikëzimit është

në raport me dokumentacionin e paraqitur, pra vlerësimi me pikë jepet duke analizuar kontratat e ngjashme në tërësinë e tyre, duke përfshirë shumë elementë të tillë si data e lidhjes, mënyra e realizimit, objekti i kontratës, vlera e saj etj, .” prandaj nga ana juaj duhet kryer rivlerësimi në proporcion me punët e ngjashme të paraqitura secili operator duke analizuar brendinë e tyre në tipin e shërbimeve të ofruara, vlerën e shërbimeve etj.

Pra e thene shkurtimisht nga ana e KVO duhet te ishte vleresuar edhe në rrafsh krahasimor te dokumentacioneve te dorezuara nga secila pale ne fazen e pare dhe te dyte ne menyre qe te kemi nje vleresim te drejte dhe jo diskriminues. Duke qene se operojme ne te njejtin treg sherbimesh, njohim edhe kapacitetet teknike dhe financiare te kompanive te ndryshme, cka dyshojme po te krahasojme kapacitetin tone me operatorin tjeter shoqeria jone ka dorezuar ne nje vlere shume te madhe sherbime te ngjashme, te cilat jane tipikisht te njejta me ato te kerkuara. Ne rrafshin e kapacitetit ekonomik shoqeria jone ka nje xhiro mesatare per tre vitet e fundit prej 126,580,957 leke, xhiro e cila nuk e ka asnjera nga kompanite e tjera ne bashkimin e operatoreve ekonomik nuk e zoteron dhe lideri i bashkimit ka nje xhiro mesatare rreth 40 000 000 leke. Ne rrafshin e kapacitetit Teknik, Instituti Dekliada-Alb SHPK ka paraqitur dhe ka ne dispozicion per realizimin e ketij sherbimi staf te kualifikuar prej 46 personash referuar listepageses te cilen do ta gjeni bashkengjitur, nderkohe B.O.E INVICTUS+ANGEBRA+TOWER SHPK nuk i ka keto kapacitete dhe po keshtu lideri i Bashkimit Invictus SHPK ka nje staf prej 5 personash. Përvoja e mëparshme, per sherbime të ngjashme e paraqitur nga ana jone i tejkalon ne vlere kerkesat e vendosura ne DST, krahasuar me sherbimet e ofruara nga B.O.E INVICTUS+ANGEBRA+TOWER SHPK

Bazuar ne certifikimet sipas standardeve iso, dhe licensat e nevojshme te lëshuara nga qendra kombetare e licensimit QKL, duket qarte qe kompania jone i tejkalon kriteret e vendosura dhe operon ne treg me sherbime ne fushen e konsulences me standarde te larta. Te gjitha pretendimet e mesiperme mund ti vertetoni duke i kerkuar autoritetit kontraktor dokumentacionet e dorezuara ne te dy fazat. Per sa me siper kerkojme rivleresimin per kriterin Cilesia duke i dhene piket maksimale Instituti Dekliada-Alb SHPK.

Gjithashtu ne kontraten e bashkëpunimit te B.O.E INVICTUS+ANGEBRA+TOWER SHPK nuk jane ndare perqindjet respektive te realizimit te sherbimit e cila nevojitet duke qene marreveshje kuader bazuar ne VKM 914 datë 29.12.2014, per te cilen autoriteti duhet ta kishte skualifikuar qe ne fazen e pare. Edhe pse ne shkelje te ligjit ne fazen e pare, gjate vleresimit ne fazen e dyte, Autoriteti Kontraktor kurrsesi nuk mund te vleresonte nje B.O.E me shume se nje operator te vetem, ku B.O.E nuk kane ndare perqindjet e pjesëmarrjes pasi nuk e ka te mundur te vleresoje mundesine e realizimit te sherbimit krahasuar me kapacitetet teknike ekonomike te secilit pjesëmarrës ne B.O.E. Pra si ka mundesi ta kete vleresuar propozimin teknik AK Bashkia Durres kur operoret kane ndare vetem sherbimet dhe jo perqindjet. Ndarja e perqindjeve eshte detyrim ligjor bazuar Në nenin 74 pika 2 të VKM 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku thuhet se "Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Bazuar ne LPP Autoriteti Kontraktor ne procedurat e pershpejtuara dhe ato normale kur zbulohen te dhena te reja mund te kryeje rivleresim te procedures para shpalljes se fituesit sic ndodhemi ne kete rast.

Duke qene ne kushte te reja per te cilat eshte njohur dhe vertetuar se duhet ta kishte skualifikuar B.O.E INVICTUS+ANGEBRA+TOWER SHPK per mosndarjen e perqindjeve. KPP dhe Bashkia Durres kane dy mundesi 1. Te skualifikoje B.O.E INVICTUS+ANGEBRA+TOWER SHPK per mospermbushje te nenit 74 pika 2 të VKM 914 datë 29.12.2014.

Ose 2. Te kryeje rivleresimin me zero pike per sa i perket Cilesise, pasi e ka te pamundur te kryeje vleresimin e sakte te nenkriterëve duke mosditur perqindjen e ndarjes se sherbimeve nese korrespondojne sipas kapaciteteve dhe sherbimeve te marra persiper nga anetaret e B.O.E INVICTUS+ANGEBRA+TOWER SHPK ne marreveshjen e bashkpunimit.

Perveç fakteve me siper duke rivleresuar proceduren keni mundesine ti shpetoni buxhetit te shtetit 4 713 434 leke te vene ne dispozicion nga programi i rindertimit, i cili bazohet ne fonde edhe te donatoreve te cilet kerkojne transparence, mosdiskriminim dhe mosabuzim me fondet duke ja dhene padrejtesisht dhe per here te pare ne procedurat e rindertimit kompanise me vleren me te larte te ofruar dhe me kohen e zbatimit me te larte [...]”

II.7. Në datën 09.06.2021, operatori ekonomik ankimues “Gjeokonsult & Co” SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, me argumentimin si më poshtë vijon:

”[...] Së pari, duhet të theksojmë se procedura e ndjekur për tenderin në fjalë është procedurë e kufizuar në kuptim të nenit 43 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe për rrjedhojë në interpretimin e ligjshmërisë së vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave duhet të aplikohen rregullat e përgjithshëm si dhe në kontekstin e lex specialis rregullat e posaçëm për këtë kategori procedurë prokurimi.

Së dyti, sipas pikës 1 të nenit 43 sipërcituar, kjo procedurë ndahet në dy faza përkatësisht faza e ftesës për ofertë gjatë së cilës vlerësohet secili kandidatë për sa i përket plotësimit të kriterëve të kualifikimit dhe më pas faza e dytë ajo e depozitimit të ofertës financiare nga të gjithë subjektet e kualifikuara gjatë fazës së parë dhe pikëzimit të secilit prej këtyre ofertave sipas kriterëve të vlerësimit dhe shpalljes eventualisht të operatorit ekonomik me më shumë pikë. Në rastin në fjalë, interesi i shprehur nga ana e Gjeokonsult & Co. SHPK është vlerësuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si një kërkesë e cila plotëson kriteret e kualifikimit. Ky fakt është bërë evident nëpërmjet shkresës nr. 4929/4 prot., datë 01.06.2021 “Ftesë për Ofertë” e cila ju drejtohet të gjithë operatorëve ekonomikë të kualifikuar, në total 7 (shtatë) operatorë, ndër ta edhe shoqëria Gjeokonsult & Co. SHPK. Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është shprehur tashmë për plotësimin e kriterëve të kualifikimit dhe për rrjedhojë në referim të parimit të sigurisë juridike ky vendim është përfundimtar për sa i përket procedurës së tenderimit objekt i këtij ankimi.

Për sa i përket plotësimit të kushteve formale të ofertës (skualifikimi i ofertës) :

Neni 89 i ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon procedurën e paraqitjes së ofertave ku përkatësisht kjo procedurë parashikon mundësinë e depozitimit të ofertës në formë elektronike ose dorazi (në zarf të mbyllur) si dhe kërkesën për respektimin e afatit të depozitimit të ofertës.

Në referim të shkresës nr. 4929/4 prot., datë 01.06.2021 si dhe DST-së, afati për dorëzimin e ofertës ishte data 03.06.2021 ora 12:00 ndërkohë që procedura për depozitimin e saj duhet të kryhej dorazi, e futur në një zarf jo transparent e vulosur dhe firmosur në emrin dhe adresën e kontraktorit, dorëzuar pranë zyrës së protokollit të bashkisë Durrës në adresën Lagja nr. 3, Sheshi “Liria”, Durrës. Ndërkohë për sa i përket formatit që duhet të përdorej, në referim të Seksionit 1 të Kapitullit II të DST-së, formati duhet të ishte sipas Shtojcës 3 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Konkluzion: Të gjitha kriteret formale të listuara më sipër janë zbatuar me përpikmëri nga ana e shoqërisë Gjeokonsult & Co SHPK e cila e ka depozituar ofertën sipas formatit të kërkuar (shtojcës 3), brenda afatit ligjor (data 03.06.2021 ora 12:00), sipas procedurës së kërkuar (dorazi në zarf të

mbyllur). Për rrjedhojë shoqëria Gjeokonsult & Co SHPK ka përmbushur plotësisht nenin 89 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe udhëzimet në DST-në përkatëse të tenderit objekt ankimi.

Për sa i përket plotësimit të kushteve materiale të ofertës (skualifikimi i ofertës) :

Në ftesën për ofertë sipas shkresës nr. 4929/4 të sipërcituar, Autoriteti Kontraktor ka saktësuar se nëse një ofertë nuk përmban të gjithë informacionin e kërkuar, ajo ofertë mund të skualifikohet nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Njëkohësisht, neni 92 i ligjit për Prokurimet Publike, në pikën 3 të tij parashikon se: “autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji” Ndërkaq në pikën 4 parashikohet se: “Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.”

Sipas pikës 3.2 të Seksionit 3 (faza 2 — paraqitja e ofertës), të Dokumenteve Standarde të Tenderit, oferta duhet të përfshijë dokumentet e mëposhtëm: a) formularin e ofertës sipas shtojcës 3: b) deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas shtojcës 4: c) dokumentet që lidhet me objektin e prokurimit (skica, etj.).

Shoqëria Gjeokonsult & Co SHPK ka zbatuar me përpikmëri të tre kriteret materiale të listuara më sipër: (i) ka depozituar formularin e ofertës ekonomike duke përfshirë këtu të gjithë të dhenat dhe informacionet e kërkuara sipas këtij formulari: (ii) ka depozituar deklaratën për paraqitjen e ofertës së pavarur sipas shtojcës 4: (iii) ka depozituar një dokument voluminoz prej 57 faqesh për propozimin teknik që lidhet me objektin e prokurimit në fjalë duke përfshirë këtu edhe skicat përkatëse, listën e personelit që do të marrë pjesë në këtë projekt shoqëruar me licencat, diplomat dhe certifikatat përkatëse, referenca mbi punë të ngjashme të kryera nga Operatori Ekonomik etj.

Konkluzion: për sa kemi analizuar më sipër, është e qartë se shoqëria Gjeokonsult & Co SHPK ka plotësuar edhe kërkesat materiale të ofertës sipas parashikimeve të nenit 92 ligjit për Prokurimet Publike si dhe informacionit të kërkuar sipas Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe shkresës nr. 4929/4 prot., datë 01.06.2021.

Për sa i përket aplikueshmërisë së VKM-së nr. 354 datë 11.05.2016:

Ashtu sic kemi përmendur edhe më sipër, shkaku për skualifikimin e ofertës së shoqërisë Gjeokonsult Co SHPK është i mbështetur mbi pretendimin se oferta e kësaj të fundit në vlerën 49,000,000 është nën vlerën minimale të projektimit sipas VKM-së 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Ky pretendim i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk qëndron për disa arsye që do të parashtrojmë në vijim: Së pari, duhet të theksojmë se referuar Dokumenteve të Tenderit në fjalë, në veçanti shtojcën 13 të tyre, janë përcaktuar të gjitha kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit të Operatorëve Ekonomik si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit. Në asnjë nga këto kritere nuk parashikohet detyrimi i operatorëve ekonomik për të dhënë një ofertë e cila është në përputhje me VKM-në 354 sipërcituar. Bazuar edhe në eksperiencën e gjatë që shoqëria Gjeokonsult ka në tregun e projektim-mbikëqyrje dhe kolaudimit, praktika administrative është që Autoriteti Kontraktor e parashikon në mënyrë të shprehur në Dokumentet e Tenderit detyrimin për të dhënë një ofertë në përputhje me VKM-në 354, gje e cila nuk është bërë në rastin konkret. Kështu po të marrim për shembull Dokumentet e Tenderit për “Rehabilitimin e Linjës së Ujësjellësit pranë

Depos Shilore, Karpen, Njësia Administrative Maminas, Bashkia Shijak”, në faqen 6 është përcaktuar shprehimisht detyrimi i subjekteve për të zbatuar VKM-në 354 në dhënien e ofertave përkatëse për këtë tender. I njëjti standard është aplikuar në të gjitha tenderët publik të cilët janë objekt i VKM-së 354. (Prova 6 — Projekt Zbatimi për rehabilitimin e linjës së ujësjellësit pranë depos shilore, Karpen, Njësia Administrative Maminas, Bashkia Shijak)

I njëjti qëndrim për sa më sipër, është mbajtur edhe nga KPP-ja në disa vendime të saj. Kështu po ti referohemi Vendimit nr. 176/2018 të KPP, kjo e fundit vendosi ta rrëzojë kërkesën e subjektit për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave vetëm për shkak se kërkesa për të aplikuar VKM-në 354 ishte parashikuar shprehimisht në Dokumentet e Tenderit. Kështu citojmë: “Komisioni i Prokurimit Publik, në rastin konkret, nisur nga informacioni dhe dokumentacioni i detajuar i dhënë nga autoriteti kontraktor, kryesisht në lidhje me përllogaritjen e fondit limit, konstaton se, nga ky i fundit janë bërë përllogaritjet edhe për përcaktimin e vlerave minimale e maksimale të mbikëqyrjes, duke u përcaktuar edhe në dokumentet e tenderit se në këtë përcaktim është bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Pra vetë autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për zhvillimin e procedurës së prokurimit ka përcaktuar që në publikimin e procedurës detaje për përcaktimin e fondit limit”. (Prova 7 — Vendimi nr. 176/2018 i KPP-së)

Detyrimi për të përcaktuar shprehimisht në Dokumentet e Tenderit kriteret për kualifikimin/skualifikimin e ofertave të Operatorëve Ekonomikë është një detyrim që buron nga Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Neni 3 i këtij ligji parashikon se autoriteti kontraktor duhet të veprojë me transparencë të plotë për të gjitha procedurat e prokurimit publik. Ky është parimi i përgjithshëm por në dispozitat vijuese elaborohet më tej lidhur me mënyra se si ligji detyron Autoritetin Kontraktor për të përmbushur detyrimin e tij për të bërë transparencë. Në nenin 77 të këtij ligji parashikohet shprehimisht se: “Autoriteti ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet konkret që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. ”. Gjithashtu edhe në pikën 3 të nenit 92 të këtij ligji është parashikuar shprehimisht se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.” Referuar dispozitave të sipërcitura, del fare qartë se Ligji për Prokurimin Publik detyron Autoritetin Kontraktor për të vepruar me transparencë të plotë duke kërkuar kështu nga ky i fundit të bëjë të qartë në Dokumentet e Tenderit të gjitha specifikimet ligjore dhe teknike të cilat mund të përcaktojnë nëse një Operator Ekonomik kualifikohet apo skualifikohet nga procedura e tenderit. Kështu, që një ofertë të konsiderohet e pavlefshme ajo duhet të vijë në kundërshtim me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit. Në rastin konkret, kërkesa për të dhënë oferta në përputhje me VKM-në 354 nuk është parashikuar në DT dhe për rrjedhojë nuk plotësohen kushtet e nenit 92, pika 3 e Ligjit për Prokurimin Publik për ta shpallur ofertën e shoqërisë Gjeokonsult & Co SHPK si të pavlefshme, dhe për rrjedhojë të vendoset skualifikimi i këtij subjekti.

Në referim të praktikës së huaj, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në Çështjen C-27/15 Pippo Pizzo ka konkluduar se detyrimi i transparencës, duhet të lexohet si ndalesë për autoritetet kontraktore që të skualifikojnë një ofertues si rezultat i në kriteri që as nuk është shprehimisht i përfshirë në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit të procedurës në fjalë. Në rastin konkret, kriteri skualifikues i përdorur nga autoriteti kontraktor, është pikërisht një rregullim që sipas këtij të fundit, buron pikërisht nga një VKM e cila nuk është listuar si kriter për hartimin e ofertës në Dokumentet e Tenderit. Për rrjedhojë, Vendimi i Komisionit të Vlerësimit është dhënë në shkelje të

detyrimin të Autoritetit Kontraktues për të bërë transparencë dhe për të përcaktuar qartë kriteret në Dokumentet e Tenderit.

Konkluzion: Në përputhje me Ligjin për Prokurimet Publike, praktikën e KPP-së, praktikën e ndjekur për Dokumentet e Tenderit nga Autoritetet Kontraktore si dhe praktikën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, të cituar më sipër, kriteret për skualifikimin e një Operatori Ekonomik duhet të parashikohen shprehimisht në Dokumentet e Tenderit në respektim të detyrimit të AK-së për të vepruar në përputhje me parimin e transparencës. Në rastin konkret, Dokumentet e Tenderit nuk e parashikojnë detyrimin për të dorëzuar oferta, vlera e të cilave duhet të zbatohet VKM-në nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Për rrjedhojë, Vendimi për skualifikimin e subjektit Gjeokonsult & Co SHPK është marrë në shkelje të ligjit dhe duhet të shfuqizohet.

Së dyti, argumenti i sipërcituar, se Autoriteti Kontraktor nuk e ka aplikuar VKM-në nr. 354, datë 11.05.2016 përforcohet edhe më tej për shkak të argumentit që do të parashikohet në vijim.

Në pikën 4.1 të Dokumenteve të Tenderit parashikohet procedura që duhet të ndiqet nga Operatorët Ekonomik gjatë fazës së parë, atë të kualifikimin të ofertave. Përkatësisht në këtë pikë parashikohet se “autoriteti përgjegjës kur e vlerëson të nevojshme mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të dorëzojnë me dokumentacionin dhe një çmim/ofertë referuese e cila gjatë fazës së dytë nuk mund të jetë më e lartë.” Kjo ofertë referuese është kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe së bashku me dokumentet e tjera janë dorëzuar nga Gjeokonsult & Co SHPK gjatë fazës së parë të kualifikimit. Oferta e depozituar gjatë kësaj faze nga shoqëria Gjeokonsult ishte në vlerën 67,860,000 lekë e cila në kuptim të VKM-së 354, datë 11.05.2016 është gjithashtu nën vlerën minimale të përcaktuar nga ky akt nënligjor.

Autoriteti Kontraktor gjatë fazës së parë kualifikuese, me anë të shkresës nr. 4929/4 prot., datë 01.06.2021, e ka kualifikuar subjektin Gjeokonsult & Co SHPK duke qenë në dijeni të plotë të ofertës financiare referuese të kësaj të fundit e cila në çdo rast, në referim të kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, nuk mund të ishte më e lartë por vetëm më e ulët se kjo ofertë.

Konkluzion: Në referim të sa më sipër, aplikimi nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të çmimit minimal sipas VKM-së 354, datë 11.05.2016 gjatë fazës së dytë të procedurës së tenderit objekt ankimi bie ndesh me qëndrimin e këtij institucioni ad hoc gjatë fazës së parë kualifikuese, kur edhe pasi ka marrë një ofertë referuese nën vlerën minimale të parashikuar nga VKM-ja 354, ky institucion gjithsesi e ka kualifikuar shoqërinë Gjeokonsult Co SHPK.

Së treti, duhet të theksojmë se procedura e tenderimit është iniciuar në referim të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, i cili është miratuar me Ligjin nr. 97/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”,

Kreu VI i ligjit sipërcituar parashikon Procedurat e Prokurimit Publik për projektet që lidhen me rindërtimin. Neni 40 i ligjit parashikon se: “Objekt i këtij kreu është përcaktimi i rregullave të posaçme që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga njësitë zbatuese në funksion të procesit të rindërtimit, përveç rasteve kur në këtë akt parashikohet ndryshe.” Në këtë kuptim, ky ligj ka natyrën e lex specialis dhe për rrjedhojë dispozitat e tij prevalojnë mbi ato të parashikuara nga Ligji për Prokurimin Publik, për sa ato aplikohen.

Neni 41 nga ana tjetër, liston parimet e prokurimit publik për rindërtimin të cila si. a) mirëpërdorimi i fondeve: b) nxitja e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik c) integritetin, besimin publik dhe transparencën: d) përzgjedhja e fituesve do të bëhet mbi, bazën e 3 kriterëve përkatësisht cilësia e shërbimit, çmimi dhe koha e zbatimit të kontratës. Në rastin në fjalë të gjitha parimet e sipërcituara janë shkelur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Shoqëria Gjeokonsult & Co

SHPK ka dhënë ofertën më të mirë financiare në vlerën 49,000,000 lekë, ofertë të cilën ka mundur ta paraqesë për shkak të ekspertizës së saj të gjatë në projekte të ngjashme si dhe për shkak se kjo shoqëri propozoi implementimin e projektit brenda 2 muajve (jo 12 muajve sa c'ishte parashikuar në DT) duke ulur kështu ndjeshëm kostot e projektit. Ky propozim vjen në kohezion të plotë me nevojat e Autoritetit Kontraktor në kuadër të kontekstit emergjent të punëve publike që lidhen me rindërtimin. Pavarësisht sa më sipër, Komisioni i Ofertave, në shkelje të parimeve të cituara në nenin 41, të qëllimit të ligjit dhe procedurës së posaçme të prokurimit vendosi skualifikimin e shoqërisë Gjeokonsult & Co SHPK.

Për sa më sipër, edhe dispozitat e ligjit 97/2019 nuk kërkojnë aplikimin e VKM-së nr. 354 apo të ndonjë akti tjetër nënligjor në përcaktimin e kriterëve kualifikues të operatorëve ekonomik. Krejt e kundërta është e vërtetë, ku për shkak të nevojës emergjente për kryerjen e kësaj kategorie punësh/shërbimesh publike, ligjvënësi ka vënë prioritet mirëpërdorimin e fondeve publike, kohën e zbatimit të kontratës dhe cilësinë e punimeve/shërbimeve. Në këtë kontekst, ka qenë qëllimi i ligjvënësit të mos kufizojë ofertën financiare, për të përdorur në mënyrë eficiente fondet publike të cilat janë të limituara për shkak të dy krizave, tërmeti i Nëntorit 2019 dhe Covid-19. Në këtë kontekst, kualifikimi vetëm i dy ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, vlera e të cilave është thujse sa vlera e fondit limit shumë larg asaj të ofertuar nga Gjeokonsult & Co SHPK, për një projekt që ky i fundit mund ta implementojë thujse 5 herë më shpejtë se dy ofertat e vetme të kualifikuara, vjen në mospërputhje të plotë me frymën e ligjvënësit në implementimin e këtyre rregullave të posaçme prokurimi (procedura e përsheptuar), për projekte që lidhen me rehabilitimin e territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore.

Për sa kemi analizuar më sipër, e vlerësojmë të nevojshme që për qëllimin e kësaj analize të ndalemi shkurtimisht dhe analizojmë rregullimet ligjore dhe hierarkinë e zbatimit të tyre, duke vijuar me normat specifike që përcaktojnë kriteret dhe mënyrat e kualifikimit të ofertuesve në procedurat e prokurimit publik dhe marrëdhëniet dhe raportet e mbi/nënvendosjes së tyre. Neni 116 i Kushtetutës ka përcaktuar hierarkinë e akteve normative, që parashikon marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik është një sistem hierarkik normash, ku në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash. Aktet normative referuar hierarkisë së tyre kanë në majë Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (shiko vendimet nr.3, datë 20.02.2006: nr.5, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese). Ndërkaq, neni 118, pika 1 e Kushtetutës parashikon se: “Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë”, ndërsa paragrafi i dytë i këtij neni parashikon se: “Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjen që duhet rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte”. Në këto dispozita, është përcaktuar edhe koncepti kushtetues “rezervë ligjore”, sipas të cilës një çështje e rregulluar me ligj mund të detajohet më tej, brenda kufijve të autorizuar nga ligji. Në rastin e rezervës ligjore, aktet nënligjore duhet të nxirren në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 118 të Kushtetutës, të cilat nga njëra anë e detyrojnë ligjvënësin t'u përmbahet atyre në mënyrë rigorozë dhe nga ana tjetër orientojnë edhe kufizojnë pushtetin ekzekutiv në nxjerrjen e akteve nënligjore (shiko vendimet nr.17, datë 25.7.2008: nr.12, datë 28.04.2009: nr.24, datë 24.07.2009: nr.7, datë 27.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Për rrjedhojë të sa më sipër, në marrjen e një vendimi përfundimtar duhet të merret parasysh jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, në të cilën, është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në

sistemin ligjor (shiko vendimet nr.1, datë 12.01.2011: nr.23, datë 08.06.2011, nr.2, datë 03.02.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

Konkluzion: Për rrjedhojë të sa më sipër, për sa kohë VKM 354 nuk vjen të përputhje dhe kohezion me një ligj, atë nr. 97/2019, në respektim të parimit të hierarkisë normave juridike, ky i fundit prevalon. Kështu rritet se, kualifikimi vetëm i dy ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, vlera e të cilave është thuhet sa vlera e fondit limit shumë larg asaj të ofertuar nga Gjeokonsult & Co SHPK, për një projekt që ky i fundit mund ta implementojë thuhet 5 herë më shpejtë se dy ofertat e vetme të kualifikuara vjen në mospërputhje të plotë me frymën e ligjvënësimit në implementimin e rregullave të posaçme prokurimi (procedura e përshpejtuar), për projekte që lidhen me rehabilitimin e territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore.

Së katërti, Komisioni për Vlerësimin e Ofertave ka shkelur pikën 5 të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili citon se: “Në rastet kur procedura e prokurimit zhvillohet në formë shkresore, autoriteti ose enti kontraktor dokumenton procesin [e hapjes së ofertave] nëpërmjet mbajtjes së një procesverbal, i cili duhet të pasqyrojë emrin, adresën e ofertuesit, oferta e të cilit hapet, dokumentacionin ligjor dhe çdo dokument të kërkuar nga autoriteti ose enti kontraktor, si dhe çmimin e çdo oferte, të cilat lexohen me zë të lartë për ata persona që janë të pranishëm dhe regjistrohet në procesverbal.” Ky procesverbal i vihet menjëherë në dispozicion çdo kandidati ose ofertuesi.

Në rastin në fjalë, Komisioni për Vlerësimin e Ofertave nuk e ka kryer këtë procedurë duke cenuar rëndë detyrimin për një proces transparent prokurimi. Qëllimi i dispozitës për të mbajtur një procesverbal lidhet me qartësinë e të gjitha palëve në proces për dokumentacionin e depozituar në procedurën e tenderimit, duke evituar kështu konflikte që lidhen me dokumentet e depozituar dhe/ose pretendime të njëanshme të njëres palë për dokumente që nuk janë depozituar. Shkelja e këtij detyrimi procedural pasjellë pavlefshmërinë e procedurës së tenderit dhe për rrjedhojë në përputhje me nenin 98 të Ligjit për Prokurimet Publike dhe nenin 108, 109 të Kodit të Procedurës Administrative, Autoriteti Kontraktues dhe/ose Komisioni i Prokurimeve Publike duhet të vendosin anulimin e procedurës së prokurimit.

Në vijim të sa kemi analizuar më sipër, Shoqëria Gjeokonsult & Co SHPK kërkon pranimin e kërkesës së saj për shkaqet se:

Komisioni për Vlerësimin e Ofertave ka shkelur praktikën e institucioneve shtetërore të cilat në rastet kur kërkojnë që oferta të zbatohet VKM-në 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, e parashikojnë këtë kriter në Dokumentet e Tenderit.

Komisioni për Vlerësimin e Ofertave nuk ka respektuar praktikën e Komisionit të Prokurimeve Publike i cili në të gjitha rastet kërkon që kriteret për kualifikimin e ofertave të përcaktohen në Dokumentet e Tenderit.

Komisioni për Vlerësimin e Ofertave ka shkelur detyrimin e nenit 3 të Ligjit për Prokurimet Publike, përkatësisht respektimin e parimit të transparencës, parim ky i cili e detyron Autoritetin Kontraktor që ta parashikojë shprehimisht në Dokumentet e Tenderit, kriterin për aplikueshmërinë e VKM-së nr. 354 sipërcituar.

Komisioni për Vlerësimin e Ofertave ka shkelur detyrimin e nenit 77 dhe 92 pika 3 të Ligjit për Prokurimet Publike, të cilët e detyrojnë Autoritetin Kontraktor që ta parashikojë shprehimisht në Dokumentet e Tenderit, kriterin për aplikueshmërinë e VKM-së nr. 354 sipërcituar dhe kushtëzojnë

Komisionin për Vlerësimin e Ofertave që të shpallë një ofertë të pavlefshme vetëm për sa kjo ofertë nuk përmbush kriteret e parashikuara në njoftimin e kontratës ose në Dokumentet e Tenderit

Komisioni për Vlerësimin e Ofertave nuk ka respektuar praktikën e huaj të Gjykatës Evropiane e Drejtësisë e cila në Çështjen C-27/15 Pippo Pizzo, ka konkluduar se detyrimi i transparencës, duhet të lexohet si ndalesë për autoritetet kontraktore, që të skualifikojnë një ofertues si rezultat i një kriteri, që as nuk është shprehimisht i përfshirë në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit të procedurës në fjalë.

Komisioni për Vlerësimin e Ofertave ka shkelur pikën 4.1 të Dokumenteve të Tenderit duke aplikuar çmimin minimal sipas VKM-së 354, datë 11.05.2016 gjatë fazës së dytë të procedurës së tenderit objekt ankimi ndërkohë që qëndrimi i këtij institucioni ad hoc gjatë fazës së parë kualifikuese, edhe pasi ka marrë një ofertë referuese nën vlerën minimale të parashikuar nga VKM-ja 354, ky institucion gjithsesi e ka kualifikuar shoqërinë Gjeokonsult Co SHPK. Theksojmë që nëse procedura i referohet VKM 354, KVO para hapjes së ofertave ka detyrim të informoj Operatorët Ekonomik mbi vlerën minimale të lejuar.

Komisioni për Vlerësimin e Ofertave ka shkelur pikën 5 të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili e detyron këtë të fundit që të mbajë një procesverbal pas hapjes së çdo zarfi të ofertave, duke kryer një shkelje të rëndë procedurale në nxjerrjen e aktit administrativ (vendimit për skualifikim), veprim i cili passjell pavlefshmërinë e këtij akti në kuptim të nenit 108 dhe 109 të Kodit të Procedurës Administrative.

Komisioni për Vlerësimin e Ofertave ka interpretuar në mënyrë të gabuar aplikueshmërinë e VKM-së 354, datë 11.05.2016 e cila nuk mund të aplikohet për rastet e procedurës së përshpejtuar në kuptim të ligjit nr. 97/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”. Kjo VKM nuk vjen në përputhje dhe kohezion me këtë ligj i cili prevalon në kuptim të hierarkisë juridike (mbi VKM-në) dhe në kuptim të parimit lex specialis (mbi Ligjin për Prokurimet Publike). Kështu ritheksojmë se, kualifikimi vetëm i dy ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, vlera e të cilave është thujt sa vlera e fondit limit shumë larg asaj të ofertuar nga Gjeokonsult & Co SHPK, për një projekt që ky i fundit mund ta implementojë thujtse 5 herë më shpejtë se dy ofertat e vetme të kualifikuara vjenë në mospërputhje të plotë me frymën e ligjvënësimit në implementimin e rregullave të posaçme prokurimi (procedura e përshpejtuar), për projekte që lidhen me rehabilitimin e territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore. [...]

II.8.Në datën 10.06.2021, autoriteti kontraktor me anë të postës elektronike, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dhe kërkesave të operatorëve ekonomikë ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues "Gjeokonsult & Co" SHPK dhe "Instituti Deklada - ALB" SHPK, KPP sqaron se procedura e shqyrtimit administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik rregullohet nga ligji nr. 97/2019 "Për miratimin e Aktit Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore. Në rastin konkret, pas shqyrtimit në tërësi të pretendimeve të ankimuesve, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ato janë kundërshtime mbi vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave për fazën e dytë të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.1. Neni 42 pika 10 i ligjit nr. 97/2019 "Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", parashikon shprehimisht se:

"Pas afatit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, siç përcaktohet në njoftimin e kontratës, autoriteti kontraktor përzgjedh kandidatët brenda 10 ditëve kalendarike. Kundër vendimit të autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve paraqitet ankim administrativ pranë KPP-së, brenda 3 ditëve nga njoftimi i kandidatëve fitues. KPP-ja shqyrton ankesën dhe merr vendim brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të ankesës, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe të këtij akti. Për efekt kohe, komunikimi midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor bëhet nëpërmjet e-mail-it zyrtar. Me kalimin e këtij afati, nëse KPP-ja nuk është shprehur me vendim, autoriteti kontraktor vijon me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit."

III.1.2. Neni 43 "Lidhja e kontratave pas marrëveshjes kuadër", të ligjit nr. 97/2019 "Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti kontraktor përgatit ftesën për ofertë dhe ia dërgon vetëm operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër.

2. Ftesa për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë përcakton afatin kohor për dorëzimin e ofertave, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 10 ditë kalendarike, kriteret e përcaktimit të ofertës fituese për kontratën e bazuar në marrëveshjen kuadër dhe çdo informacion të nevojshëm për përgatitjen e ofertave.

3. Autoriteti kontraktor, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së ofertave, përzgjedh ofertën fituese.

4. Menjëherë, por në çdo rast jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së ofertës fituese, autoriteti kontraktor fton operatorin fitues të lidhë kontratën. Përpara nënshkrimit të kontratës, operatori ekonomik fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një sigurim kontrate prej 15% të vlerës së saj. Sigurimi i kontratës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga autoritetet shtetërore për të ushtruar këtë veprimtari.

III.1.3. Neni 23 "Verifikimi i kompetencës" i ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës Së Shqipërisë" i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: "Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi.

2. Çdo ndryshim ligjor ose nënligjor i mëvonshëm i kompetencës nuk ka efekt, përveç rasteve kur organi, në të cilin procedura ka nisur, nuk ekziston më, ose kur legjislacioni i ri parashikon ndryshe."

Neni 24 "Mungesa e kompetencës" i ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës Së Shqipërisë" i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Kur një organ publik merr një kërkesë, për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës të vet, ia përcjell kërkesën menjëherë, dhe në çdo rast jo më vonë se dy ditë nga marrja e saj, organit publik kompetent dhe njofton kërkuuesin për këtë.

2. Afatet për kërkuuesin vlerësohen të respektuara nëse kërkesa është paraqitur në kohë pranë organit jokompetent, ndërsa afatet përkatëse për organin publik kompetent fillojnë të llogariten nga data e marrjes së kërkesës.

3. Palët nuk mund të përcaktojnë apo të ndryshojnë, me marrëveshje, kompetencën e organit publik.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në kuptim dhe zbatim të drejtë të parashikimeve ligjore të sipërcituara, në procedurat e prokurimit në fushën e rindërtimit, operatorët ekonomikë mund të ngrenë pretendimet e tyre vetëm sa i takon vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave për fazën e parë të procedurës së prokurimit. Në këtë fazë operatorët ekonomikë kanë në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tyre pranë KPP-së, brenda 3 ditëve nga njoftimi i kandidatëve fitues.

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i informacionit të administruar për çështjen objekt ankimi rezulton, se ankimuesit kanë pretendime mbi vlerësimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në fazën e dytë të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Faza e dytë e procedurës rregullohet nga neni 43 i aktit normativ nr.9 të sipërcituar, ku në asnjë rast ligjvënësi nuk parashikon procedurë ankimimi për këtë fazë. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se pretendimet e mësipërme të ngritura nga operatorët ekonomikë ankimues pranë KPP-së lidhur me fazën e dytë të procedurës, nuk mund të jenë objekt ankese pranë KPP-së.

Komisioni i Prokurimit Publik referuar kuadrit ligjor në fuqi, vlerëson se ankimimet e operatorëve ekonomikë ”Gjeokonsult & Co” SHPK dhe ”Instituti Dekliada - ALB” SHPK janë jashtë kompetencës lëndore të KPP-së pasi akti normativ me fuqinë e ligjit nr.9 datë 16.12.2019, nuk parashikon ankim lidhur me fazën e dytë të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në asnjë dispozitë ligjore të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.9 datë 16.12.2019 nuk parashikohet e drejta e operatorëve ekonomikë për ankim lidhur me fazën e dytë të procedurës së prokurimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, sikundër parashikuar për fazën e parë të saj. Komisioni sqaron se kompetenca lëndore është e drejtë dhe detyrë e një organi që të vendosë për çështje të veçanta nga tërësia e çështjeve administrative. Çdo organ ka kompetencën e tij lëndore për të vendosur në çështje të caktuara administrative, prandaj ai duhet të ketë kujdes që të vendosë vetëm mbi ato çështje për të cilat ka kompetencë lëndore. Caktimi i kompetencës lëndore bëhet me dispozitat që rregullojnë një fushë të caktuar ose që caktojnë kompetencat e organeve të veçanta administrative.

Sa më sipër në bazë të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit), rezulton, se Komisioni i Prokurimit Publik nuk ka kompetencë lëndore në shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë ”Gjeokonsult & Co” SHPK dhe ”Instituti Dekliada - ALB” SHPK, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji nr. 97/2020 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

Në këto kushte, këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenit 42 e vijues të Ligjit Nr. 97/2020 „Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik ”Instituti Dekliada - ALB” SHPK për procedurën e prokurimit “*“E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit”*”, me objekt “*Hartimi i studim-projektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto - Romanos - Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit*”, me nr. REF-94911-05-08-2021, me fond limit 87,006,741 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik ”Gjeokonsult & Co” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1017 protokollit Datë 09.06.2021;

Nr. 1018 protokollit Datë 09.06.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri